



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 400/01-29836, dt. 29 Maj 2025

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e bashkëpronarëve privat Salih (Bekë) Lajqi me 5/12, Ali (Sadik) Abazaj me 5/12 dhe Sali (Shaban) Lajqi me 2/12, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 29 Maj 2025, mori këtë:

VENDIM

Nr. 32/2025

Mbi Miratimin për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit privat me qëllim: "Të Zgjerimit të Rrugës Ekzistuese", si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të zgjerimit të rrugës ekzistuese si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.
- II. Parcela kadastrale nr:572-2 në sipërfaqe prej 96m² ZK Brestovik, pronë e bashkëpronarëve Salih (Bekë) Lajqi me 5/12, Ali (Sadik) Abazaj me 5/12 dhe Sali (Shaban) Lajqi me 2/12 do të merret me qëllim, të zgjerimit të rrugës ekzistuese, si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe në të njëjtën kohë do të jetë objekt këmbimi me parcelën kadastrale nr. 665-5 me sipërfaqe prej 96m² ZK Brestovik pronë Komuna e Pejës.
- III. Këto prona janë dërguar për Vlerësim në Departamentin për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave në Prishtinë.
- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do t'i nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike.

- VI. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

MAPL,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ- së
Arkivës.



KRYESUESI I KUVENDIT,
Rexhep Kurtbogaj